

**STATUTI**  
**I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZAR**  
**“MOKAROMA AL” SH.P.K**

Silvana Karalliu, shtetase shqiptare e datëlindjes 16.05.1985, lindur dhe banues ne Vlore mbajtëse e letërnjoftimit 027761184

Michele Cinquepalmi, shtetas italian I datëlindjes 22.11.1971. lindur dhe banues ne Trepuzzi, Lecce, Itali, mbajtës I letërnjoftimit me numër CA45845FI

Cosimo Lezzi, shtetas italian, i datëlindjes 03.06.1960, lindur dhe banues ne Copertino, Lecce, Itali, mbajtës i pasaportës me numër YB2913091

Kane vendosur te nenshkruajne statutin e meposhtem te nje shoqerie me pergjegjesi te kufizuar, aktiviteti i se ciles rregullohet nga legjislacioni shqiptar ne fuqi dhe nga ky statut.

**Neni 1**

**Emërtimi i shoqerise**

Shoqeria do te emertohet “MOKAROMA AL” sh.p.k.

Shoqeria eshte person juridik dhe ushtron veprimtarine ne baze te Ligjit Nr.9901 ,date 14.04.2008“ Per tregtaret dhe shoqerite tregtare”.

**Neni 2**

**Selia e shoqerise**

Selia e shoqërisë “MokAroma AL” shpk është ne adresen : Lagja “Pavarsia”, Rruga “Cajupi”, pall. ish kombinatit te Konservave, Vlore.

Shoqëria mund të ushtrojë aktivitetin e saj në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë ashtu dhe jashtë saj. Shoqëria sipas parashikimeve të këtij statuti dhe legjislacioni në fuqi, mund të hap në Shqipëri edhe jashtë saj, qendra, përfaqësi apo filiale, degë dhe shoqëri të tjera.

**Neni 3**

**Kohëzgjatja e veprimtarise**

Shoqëria do të ushtroje aktivitetin tregtar dhe do të jete subjekt i te drejtes shqiptare deri me 18.11.2030. Ky afat mund të ndryshohet një ose më shumë herë, me vendim të asamblese se ortakeve te shoqërisë

#### **Neni 4**

#### **Objekti**

Objekti i veprimtarise ekonomike te shoqërisë eshte :  
tregtia me shumice e pakice e kafesë, tregtimi i artikujve te ndryshëm ushqimor e industrial me shumice e pakice.

#### **Neni 5**

#### **Kapitali i regjistruar**

Kapitali i shoqerise eshte i ndare përkatësisht:

Zj. Silvana Karalliu eshte zotëruese e 1 kuote me vlere 34.000 (tridhjet e katër mije ) leke qe përfaqëson 34 % te kapitalit te shoqerise.

Z. Michele Cinquepalmi eshte zotërues i 1 kuote me vlere 33.000 (tridhjet e tre mije) leke qe perfqason 33 % te kapitalit.

Z. Cosimo Lezzi eshte zotërues i 1 kuote me vlere 33.000 (tridhjet e tre mije) leke qe perfqason 33 % te kapitalit.

Kapitali i shoqerise mund te rritet apo te zvogelohet me vendim te ortakeve te shoqerise, por jo nen vlerën e kapitalit fillestar.

#### **Neni 6**

#### **Mënyrat e fitimit dhe kalimit të kuotave**

Kuotat e kapitalit të shoqërisë "MokAroma al" shpk e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund

të fitohen apo kalohen nëpërmjet:  
kontributit në kapitalin e shoqërisë;  
shitblerjes;  
trashëgimisë;  
dhurimit

çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj

Në rastin e kalimit të kuotave me kontratë, kontrata duhet të bëhet me shkrim. Kalimi i kuotave, veçanërisht miratohet nga asamblea e ortakeve të shoqërisë.

## **Neni 7**

### **Asamblea e Ortakeve**

### **Të drejtat dhe detyrimet**

1. Asamblea e Ortakeve është organi i vendimit marrës i shoqërisë
2. Asamblea e ortakeve është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtme:
  - a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
  - b) ndryshimet e statutit;
  - c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
  - ç) emërimin e shkarkimin e likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
  - d) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat "c" dhe "ç" të kësaj pike;
  - dh) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
  - e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
  - ë) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
  - f) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
  - g) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
  - gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
  - h) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
  - i) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.
3. Asamblea e Ortakeve merr vendime për çështjet e përcaktuara në shkronjat "e" dhe "ë" të pikës 2 të këtij neni, pas marrjes dhe shqyrtimit të dokumenteve përkatës
4. Vendimet e paregjistruara në regjistrin e vendimeve janë absolutisht të pavlefshme. Shoqëria nuk mund t'i kundërshtojë pavlefshmërinë të tretit, që ka fituar të drejta në mirëbesim, përveç rastit kur shoqëria provon se i treti ka pasur dijeni për pavlefshmërinë, apo në bazë të

rrethanave të qarta nuk mund të mos kishte pasur dijeni për të.

5. Asamblea e Ortakeve merr vendim në rastet e përcaktuara nga ky ligj, nga ligje të tjera ose nga dispozitat e statutit dhe sa herë që është e nevojshme për të mbrojtur interesat e shoqërisë.

6. Asamblea e Ortakeve vendos për bilancin vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, kur rezulton ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim.

## **Neni 8 Përfaqësimi**

1. Administratori i shoqërisë mund të përfaqësojë shoqërinë vetëm mbi bazë të një autorizimi me shkrim të leshuar nga Asamblea e ortakeve në të cilin përcaktohet motivi i autorizimit dhe koha e vlefshmerisë së tij.

## **Neni 9 Vendimet e Asamblese së Ortakeve**

1. Të gjitha vendimet e asamblese së ortakeve duhet të regjistrohen. Administratorët përgjigjen për ruajtjen e kopjeve të vendimeve të asamblese së ortakeve.
2. Vendimi duhet të përmbajë datën, vendin, qëllimin e tij.
3. Vendimi nënshkruhet nga antaret e asamblese.

## **Neni 11 Drejtimi dhe administrimit**

Shoqëria tregtare "MOKAROMA AL" shpk do të drejtohet nga një administrator që emërohet me vendim të Asamblese së Ortakeve. Administratori i shoqërisë për periudhën 5 vjetore duke filluar nga data e sotme deri me datën 17.11.2025 do të jetë zj. Silvana Karalliu  
Administratori ka të drejtë e detyrohet të :

- Kryej te gjitha veprimet e administrimit te veprimtarise tregtare te shoqerise, duke zbatuar politika tregtare te vendosura nga asamblea e ortakeve.
- Perfaqesoje shoqerine tregtare
- Kujdeset per mbajtjen sakte e te regullt te dokumentave dhe te librave kontabel te shoqerise
- Pergatit dhe nenshkruan bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurise se veprimtarise dhe se bashku me propozimet per shperndarjen e fitimeve ,i paraqet keto perpara asamblese se ortakeve per miratim,
- Krijon nje sistem paralajmerimi ne kohen e duhur per rrethanat qe kercenojne mbarevajtjen e veprimtarise dhe ekzistencen e shoqerise,
- Kryen regjistrimet dhe dergon te dhenat e detyrueshme sic parashikohen ne ligjin per Qendren Kombetare te Rregjistrimit
- Raporton para asamblese se ortakeve te shoqerise ne lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve te posacme me rendesi te vecante per veprimtarine e shoqerise tregtare,

## **Neni 12**

### **Kontrolli i brendshem**

Shoqeria tregtare organizon kontrollin e brendshem me nje ekspert kontabel te regjistruar, i cili eshte pergjegjes perpara shoqerise per demet qe mund te shkaktoje nga moskryerja ne regull e detyres se tij

## **Neni 13**

### **Bilancet dhe te ardhurat**

Veprimet ekonomike e financiare te shoqerise do te mbyllen me 31 dhjetor te cdo viti, pervec rasteve e urdherave te vecanta te Asamblese se Ortakeve.

Ne fund te cdo periudhe ushtrimore nxiret bilanci kontabel dhe rezultati ekonomik humbje/fitim. Bilanci kontabel miratohet brenda dates 31 mars te viti paseardhes dhe pas pagimit te detyrimeve fiskale pjesa qe mbetet i jepet per perdorim asamblese se ortakeve te shoqerise.

## **Neni 14**


**Neni 14**  
**Dispozitat perfundimtare**

Per sa nuk eshte shprehur plotesisht ne kete statut do i referohet plotesimeve nga Asambleja e Ortakeve te shoqerise.

Shoqeria "MokAroma AL" shpk do te jete subjekt i te drejtes shqiptare dhe do ushtroje aktivitetin e saj ne perputhje me normat e legjislacionit shqiptar ne pergjithesi ,normat e ketij statuti dhe te aktit themelues bashkangjitur .

Ky statut nenshkruhet nga ana e Ortakeve te shoqerise ne daten 17.11.2020

**ORTAKET E SHOQERISE "MOKAROMA AL" shpk**

Three handwritten signatures in blue ink are present below the text. The first signature is the most prominent and appears to be 'Mok Aroma'. The second signature is partially obscured and appears to be 'shpk'. The third signature is smaller and less legible.